Rekomandime për raportim etik për fëmijët dhe të rinjtë

Duke njohur nevojën mediat t'i përmbahet standardeve më të larta etike dhe profesionale për raportim për fëmijët dhe të rinjtë, si dhe të kontribuojë në mënyrë aktive në përpjekjet për përmirësimin e mjedisit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, **Këshilli i Etikës në Media të Maqedonisë (KEMM)**, në partneritet me **Ambasadën e Parë të Fëmijëve në Botë "Megjashi"**, bazuar në konventat ndërkombëtare, Ligjin për drejtësi për fëmijë, Kodin e gazetarëve dhe Udhëzimet për raportim profesional në mediat online, publikon rekomandimet e mëposhtme:

1. **Të respektohet dhe të afirmohet dinjiteti i fëmijëve dhe të rinjve,** si dhe të përfaqësohen dhe promovohen të drejtat dhe interesat e tyre në të gjitha rrethanat e raportimit gazetaresk;

2. **Fëmijët dhe të rinjtë nuk duhet të diskriminohen mbi asnjë bazë** (gjinia, seks, përkatësi etnike, mosha, feja, arsimimi, aftësitë fizike, etj.);

3. **Të raportohet në një mënyrë që është e lirë nga stereotipat dhe sensacionalizmi,** me respektim të privatësisë dhe ruajtjen e nderit dhe reputacionit të fëmijëve dhe të rinjve;

4. **Të mundësohet zbatimi përkatës i së drejtës së fëmijëve dhe të rinjve** për të shprehur pikëpamjet e tyre, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre dhe ato të merren parasysh në raportimin gazetaresk;

5. **Të sigurohet e drejta e fëmijëve dhe të rinjve** për të pasur qasje në media dhe përmbajtje mediatike, kurdoherë që është e mundur, për të shprehur pikëpamjet e tyre pa asnjë ndikim, me çka do të shmanget margjinalizim i temave që lidhen me fëmijët dhe të rinjtë në raportimet e tyre të përditshme;

6. **(6) Të ndërtojë dhe zbatojë politikë editoriale të mediave,** që vë në plan të parë nevojat dhe interesat më të mira të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente informacionin dhe ngjarjet që kanë të bëjnë me fëmijët dhe të rinjtë, me një rol të theksuar edukativo-parandalues të mediave;

7. **Të krijohen mekanizma në media për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë** nga raportimi mediatik i bazuar në dezinformim, propagandë politike dhe agjitacion, manipulim ekonomik, përmbajtje pornografike, fanatizëm fetar, krijim dhe nxitje të stereotipeve dhe diskriminimit mbi të gjitha bazat;

8. **Të sigurohet mbrojtja e privatësisë së fëmijëve dhe të rinjve** kur raportohen për ta si viktima ose kur shfaqen si burim informacioni, përkatësisht pa zbuluar identitetin e tyre (për shembull, duke zbuluar informacione për familjen, vendbanimin, shkollën etj.)

9. **Të mos përdoren fotografi, deklarata dhe video të fëmijëve dhe të rinjve** pa pëlqimin e prindit / kujdestarit / institucionit-kujdestarit. Njëkohësisht, media duhet të ruajë të drejtën që të mos publikojë informacionin nëse vlerëson se do të shkaktojë më shumë dëm, gjegjësisht i mituri do të ekspozohet ndaj rrezikut pavarësisht pëlqimit të siguruar paraprakisht;

10. **Të turbullohet fytyra dhe emri i fëmijëve dhe të rinjve,** me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për informacione dhe ngjarje me kontekst pozitiv dhe me pëlqimin paraprak të fëmijës, prindit/kujdestarit/ institucionit-kujdestarit;

11. **Të respektohet prezumimi i pafajësisë së fëmijëve dhe të rinjve,** njëlloj si tek të rriturit, siç është e rregulluar me Kodin e etikës së gazetarëve dhe si e drejtë e garantuar kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Rekomandimet për raportim etik për fëmijët dhe të rinjtë janë zhvilluar në kuadër të projektit *"BE mbështetje për përmirësimin e etikës mediatike"*, financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian.

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

BE-ja me TY

KËSHILLI PËR ETIKË NË MEDIA NË MAQEDONI